



N.H.
V.P. „IBER-LEPENC” S.P.
D.D.

01-1740/11.06.2010

PRISHTINË - PRISHTINË



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE “IBËR - LEPENC” SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE “IBËR - LEPENC” J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE “IBËR - LEPENC” D.D.

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Priština, Kosovo
Tel: 038/226-070, 225-006, Fax: 038/226-159; Email: info@ iber-lepenc.org

RREGULLORE PËR PËRDORIMIN E TELEFONAVE FIKS DHE MOBIL

PRISHTINË, MAJ 2010

RREGULLORE PËR PËRDORIMIN E TELEFONAVE FIKS DHE MOBIL

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e shumës maksimale të shpenzimit të telefonisë mobile dhe fikse në Ndërmarrjen Hidroekonomike "Iber-Lepenci" SH.A, si dhe procedurën e përdorimit të rregullt dhe efikas të telefonisë, gjatë kryerjes së punëve dhe ushtrimit të përgjegjësisive nga punëtorët e Ndërmarrjes.

Neni 2 E drejta për mbushje të telefonit

(1) Të drejtë për mbushje të telefonit mobil kanë si vijon:

1. Kryeshefi Ekzekutiv, roaming deri në 150 € në muaj, e përhershme;
2. Shefi i Kabinetit të KE, 50 € në muaj;
3. Këshilltari i KE, 50 € në muaj;
4. Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit, 50 € në muaj, e përhershme;
5. Sekretari i Ndërmarrjes, 50 euro, e përhershme;
6. Zyrtari i Auditimit të Brendshëm, 50 euro, e përhershme;
7. Drejtorët e Njësive, 50 € në muaj, e përhershme;
8. Drejtori i Administratës së Përgjithshme, 40 € në muaj, e përhershme;
9. Drejtori i Prokurimit, 40 € në muaj, e përhershme;
10. Zyrtari i Prokurimit, 20 € në muaj, e përhershme;
11. Udhëheqësit e NJ.P. si dhe stafi profesional deri 20 € në muaj gjatë sezonës.

Sipas nevojave për punë Kryeshefi Ekzekutiv ka të drejtë aprovimi të shpenzimeve të telefonisë mobile edhe për ndonjë rast të veçantë.

Neni 3 Pajisja me aparat-telefon mobil

Të drejtë për pajisje me aparat telefonik të dorës (mobil) dhe SIM kartelë (brenda një mandati) kanë vetëm punëtorët nga numri rendor 1 deri në numrin rendor 9 nga neni 2, paragrafi 1, të kësaj Rregulloreje.

Neni 4 E drejta për përdorim të telefonisë fikse

Të drejtë përdorimi të telefonisë fikse kanë të gjithë punëtorët e Ndërmarrjes nga neni 2, paragrafi 1, të kësaj Rregulloreje, si dhe çdo punëtor tjetër i Ndërmarrjes me qëllim të realizimit të detyrave të punës varësisht nga natyra e punës.

Neni 5
Shpenzimet mujore për telefon fiks

(1) Shpenzimet mujore maksimale të punëtorëve për telefon fiks janë përcaktuar si më poshtë:

1. Kryeshefi Ekzekutiv, 100 € në muaj;
2. Shefi i Kabinetit të KE, 30 € në muaj;
3. Këshilltari i KE, 30 € në muaj;
4. Asistenti/ja e KE, 60 € ne muaj
5. Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit, 30 € në muaj;
6. Sekretari i Ndërmarrjes, 30 euro;
7. Zyrtari i Auditimit te Brendshëm, 30 euro;
8. Drejtor i Njësisë Afariste 'Uji dhe Centrali, 70 € në muaj;
9. Drejtor i Njësisë Afariste 'Ujitja'', 50 € në muaj;
10. Drejtori i Administratës se Përgjithshme, 30 € në muaj;
11. Drejtori i Prokurimit, 30 € në muaj;
12. Zyrtari i Prokurimit, 20 € në muaj;
13. Udhëheqësit e Njësive Punuese, 30 € në muaj.

(2) Shpenzimet e shfrytëzimit të centralit telefonik, nga te gjithë punëtoret e tjerë te Ndërmarrjes, lejohen deri në 30 €/ muaj, pa dalje me 0.

Neni 6

Tejkalimin e shpenzimeve telefonike të rregulluara me këtë rregullore mund ta aprovoj KE, kur ai vlerëson se tejkalimi i shpenzimeve është në funksion të realizimit të detyrave të punës. Në të kundërtën tejkalimin e shpenzimeve mbi vlerën e përcaktuar me këtë rregullore e bartë vet punëtori i cili ka bërë tejkalimin.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryeshefi Ekzekutiv të Ndërmarrjes.

31.05.2010



Kryeshefi Ekzekutiv

Hajdar Beqa



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE “IBËR - LEPENC” SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE “IBËR - LEPENC” J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE “IBËR - LEPENC” D.D.

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Priština, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenci.org

RREGULLORE

PËR

NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR PËRDORIMIN E TELEFONAVE FIKS DHE MOBIL

Prishtinë, Shkurt 2015

Sipas rekomandimit të Bordit të Drejtorëve NH „Ibër-Lepenc“ SH.A. „Ibër - Lepenc“ - Prishtinë, të dalë nga mbledhja e I-rë, të mbajtur më dt. 28.01.2015, me qëllim të kualitetit, efikasitetit dhe kostos më të ulët për komunikim përmes pakos në Valën 900, në Rregulloren për përdorimin e telefonave fiks dhe mobil nr. 01-1740 dt. 11.06.2010, kryhen këto ndryshime dhe plotësime:

Neni 1

Përmbajtja e dispozitave në nenin 2 të Rregullores bazë hiqet në tërësi dhe në vend të saj vie teksti me këtë përmbajtje:

Të drejtë të rimbushjes me PRE-PAID dhe POST-PAID të telefonit mobil nga VALA 900, si dhe rrethin (cug) në mes të gjithë të punësuarve në Ndërmarrje e kan këto kategori:

1. Në kategorinë e parë, ku bëjnë pjesë, përveç Kryeshefi Ekzekutiv edhe i tërë Stafi Menaxherial i Ndërmarrjes, duke përfshirë edhe Këshilltarin e KE përfitojnë pakon mujore POST-PAID prej 840 minuta;
2. Në kategorinë e dytë, ku bëjnë pjesë, Udhëheqësit e NJ. Punuese, Udhëheqësi i Investimeve Kapitale, shefi i operimit të mirëmbajtje ndërtimore, Shefi i Shërbimit të elektromakinërisë dhe Shefi i Zyrës për komunikim..... përfitojnë pakon mujore PRE-PAID prej 410 minuta dhe rrethin;
3. Në kategorinë e tretë, ku bën pjesë Stafi si në regjistrin shtojcë e Rregullores, përfitojnë pakon mujore PRE-PAID prej 270 minuta dhe rrethin;
4. Në kategorinë e katërt, ku bën pjesë Stafi si në regjistrin shtojcë e Rregullores, përfitojnë pakon mujore PRE-PAID prej 130 minuta dhe rrethin dhe
5. Në kategorinë e pestë, ku bën pjesë Stafi tjetër i Ndërmarrjes si në regjistrin shtojcë e Rregullores, përfitojnë rrethin (CUG).

Përfituesit sipas kategorive të lartpërmendura, nëse i tejkalojnë limitet e lejuara, ndryshimi i pagesës, të njëjtëve, do t'iu zbritet nga paga e pare e ardhshme.

Neni 2

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit të saj nga dita e aprovimit të saj, me aplikim nga dt. 01.02.2015.

Neni 3

Ndryshimi dhe plotësimi me këtë Rregullore janë pjesë përbërëse e Rregullores bazë të dt. 11.06.2010.

Shtojcë: Regjistri i kategorizimeve të punëtorëve.



U.D. KRYESHEFI EKZEKUTIV

Demë Abazi
Demë Abazi



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE „IBËR - LEPENC” SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE „IBËR - LEPENC” J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEÇE „IBËR - LEPENC” D.D.

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Priština, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber_lepenci.org

REGULLORE

PËR

NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR PËRDORIMIN E TELEFONAVE

FIKS DHE MOBIL

Prishtinë, Mars 2015

Neni 1

Në Rregulloren për përdorimin e telefonave fiks dhe mobil 01-1740 dt. 11.06.2010, teksti ekzistues në nenin 5 hiqet në tërësi dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:
Shfrytëzuesit e telefonisë fikse do t`a shfrytëzojnë pakon e re të quajtur „Tiktel 10000” me kosto mujore për numër telefonik prej 7.99 € me TVSH, përveç dy numrave në centralin e Ndërmarrjes, të cilëve kostoja mujore ju rritet për shkak të ndalesës për thirrje ndërkombëtare dhe mobile, me kosto mujore për numër prej 10.99 € me TVSH.

Neni 2

Tejkalimi e shpenzimeve telefonike të rregulluara me këtë Rregullore mund ta aprovoj KE, kur ai vlerëson se tejkalimi i shpenzimeve është në funksion të realizimit të detyrave të punës. Në të kundërtën tejkalimin e shpenzimeve mbi vlerën e përcaktuar me këtë Rregullore e bartë vet punëtori i cili ka bërë tejkalimin.

Neni 3

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit të saj, me aplikim nga dt. 01.04.2015.

Neni 4

Ndryshimet dhe plotësimet me këtë Rregullore janë pjesë përbërëse të Rregullorës bazë, nr. 01-1740 dt. 11.06.2010.

Neni 5

Këto ndryshime dhe plotësime të Rregullores të publikohen në tabelat e shpalljeve në Drejtori dhe NJ.P.

